



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:097919
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05539617

C.nr.1312/20

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.J. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, me numër personal ..., kundër të paditurit Z. (S.) K. më parë nga fshati ...-Komuna Ferizaj, tani nga N., të cilin e përfaqëson av. M.P. nga Shtërpca, me objekt kontesti vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5,000 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datën 07.03.2024 kurse me datën 03.04.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit K.J. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, kundër të paditurit Z. (S.) K. nga fshati ... - Komuna Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe vërtetohet se paditësi në muajin nëntor të vitit 1994 nga paraardhësi i të paditurit nga baba i tij S.K. ish nga fshati ..., e ka blerë parcelën kadastrale P-...-0, vendi i quajtur “K. andej k.”, arë e klasës së 3, në sipërfaqe prej 9298 m² ZK K., dhe se i padituri si pasardhës ligjor i babait të tij S.K. është i obliguar që këtë ta pranojë dhe parcelën e lartcekur ta bartë në paditësin si blerës dhe atë menjëherë pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim paditësit do t’i shërbejë si dokument tabular për regjistrimin e të drejtës në pronësi për parcelën e blerë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi kundër të paditurit me datën 17.08.2020, ka ngritur padi me bazë juridike vërtetim pronësie. Në padi ka theksuar se paditësi nga paraardhësi i të paditurit – nga babai i tij S. (J.) K. ish nga fshati ..., në nëntor të vitit 1994 e ka blerë parcelën kadastrale P-...-0 vendi i quajtur “S.p.b – K.andej k.” arë e klasës së 3, në sipërfaqe prej 9298 m² ZK K., për shumën prej 18,000 DM, respektivisht tani 8,000€, çmimin menjëherë ja ka paguar S. kurse S. menjëherë atij ia ka dorëzuar në posedim parcelën e lartcekur. Bartjen nuk e kanë bërë dhe se parcela e lartcekur edhe sot udhëhiqet në emër të paraardhësit të të paditurit – babait të tij S. Bartja e parcelës nuk është bërë me kontratë të vërtetuar në gjykatë për arsye se në atë kohë ishte në fuqi Ligji për ndalimin e qarkullimit të patundshmërive në mes të nacionaliteteve të ndryshme. Me rastin e arritjes së marrëveshjes për shitblerjen e parcelës së lartcekur dhe pagesës së çmimit të kontraktuar prezent

kanë qenë R.J. dhe A.J. të dy nga fshati ..., të cilët i propozoj si dëshmitarë. Padiësi përmes parashtrësës së datës 19.12.2023, ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Në referatin e padisë kam theksuar se PK P-...-0 vendi i quajtur “S.p.b.– K.a.k.” arë e klasës së 3, në sipërfaqe prej 9298 m² ZK K., të cilën e kam blerë nga shitësi i ati i të paditurit S.K. me të cilin rast ka qenë prezent edhe S. i vetmi trashëgimtar i të paditurit Z.K.. Këtë fakt e vërteton edhe Z.K. NRL ... nga dt. 17.08.2020 të vërtetuar te noteri G.H. nga Ferizaj në emër të të autorizuarit M.P. në emër tim dhe llogarisë sime të pranon kërkesëpadinë e padiësit K.J.. Të autorizuarit i është e kuartë se shitësi i parcelës kadastrale është S.K. ndërsa blerës është K.J.. Unë nuk mundem me padië tani shitësin S.K.in por trashëgimtarin e tij Z. pasi në padi e kam shkjaruar. Pasi ka kaluar kohë e gjatë mund të kem harruar ndonjë fakt por edhe me ndëgjimin e dëshmitarëve është faktike se pronën e kam blerë nga shitësi S.K. e ai ka vdek tani jam detyruar ta padisë të vetmin trashëgimtar të tij Z.K.in. Në fjalën përfundimtare padiësi ka theksuar se ajo që më është kërkuar herën e fundit – rifreskim i padisë do të thotë e kam sjellë në gjykatë dhe e lus gjykatën që këtë padi ta përfundoj. Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurit av. M.P. nga Shtërpca në përgjigjen në padi të datës 17.12.2020 ka theksuar se i kam kuptuar thëniet nga padia dhe kërkesëpadija e padiësit K.J. dhe nga ana ime dhe nga ana e të paditurit Z.K. e pranoj kërkesëpadinë e padiësit. Nuk ka fakte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse. Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare në tërësi e ka pohuar kërkesëpadinë e padiësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Fleta poseduese e datës 29.09.1994, e gjuhës serbe, Certifikatën e pronës e datës 06.08.2020 në emër të personit S.K. (draft), Ekspertiza e ekspertit gjeodet M.L. e datës 01.11.2023, Ekstrakti i lindjes i padiësit i datës 27.12.2023, i lëshuar nga ZGJC në Ferizaj, si dhe Certifikatë e lindjes e datës 29.04.2015 e padiësit e lëshuar nga ZGJC në K., Certifikatë e vdekjes e personit J.J. e datës 27.12.2023 e lëshuar nga ZGJC Ferizaj, si dhe leximi i deklaratave të dy dëshmitarëve R.J. dhe A.J., nga fsh....

Gjendja faktike e vërtetuar dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pas vlerësimit të deklaratimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që ka gjetur se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Me leximin e ekspertizës nga lëmi i gjeodezisë së punuar nga Dr.sc. M.L. nga Ferizaj, e datës 01.11.2023, vërtetohet se në bazë të dokumenteve të prezentuara nga ana e AKK të Kosovës të dt. 31.10.2023 të evidentuar në certifikatën e pronësisë është vërtetuar se parcela ...-0 ZK K. me sipërfaqe 9298 m² me kulturë arë e klasës 3 është pronë private me pronar S.(J.) K. me pjesë të pronës 1/1. Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se parcela ...-0 ZK K. kufizohet në anën veriore në gjatësi prej 179.42m kufizohet me parcelën ...-0 ZK K., në anën lindore në gjatësi prej 50.95 m kufizohet me parcelën ...-0 ZK K., në anën jugore në gjatësi prej 178.30 m kufizohet me parcelën ..-0 ZK K., në anën perëndimore në gjatësi prej 53.32 m kufizohet me hekurudhë. Në parcelën ...-0 ZK K. për të cilën është objekt kontesti nuk ka të ndërtuar ndonjë

objekt por është arë e mbjellur me grurë. Më pas, eksperti pasi që kishte përpiluar këtë ekspertizë, ishte ftuar për sqarime në gjykatë në seancën e datës 11.12.2023, ndërkaq palët ndërgjyqëse përkatësisht paditësi dhe i autorizuari i të paditurit deklaruan se e kanë pranuar ekspertizën me kohë ndaj ekspertit nuk kanë pyetje as nuk kërkojnë sqarime shtesë. Gjykata i fali besimin e plotë kësaj ekspertizë gjeodezike, pasi që e njëjta ka pasqyruar në tërësi gjendjen faktike e për më tepër, as palët ndërgjyqëse nuk e kanë kontestuar dhe as që i kanë bërë vërejtje, e po ashtu edhe sipas konstatimit të gjykatës, e njëjta i përmban të gjitha elementet e nevojshme që duhet ti ketë një ekspertizë, e njëjta është dhënë mbi bazën e njohurive profesionale të ekspertit të cilën gjykata e vlerësoi si të drejtë. Ekspertiza për më tepër ka në përmbajtje edhe certifikatën e pronës për ngastrën lëndore, skicën e matjes dhe fotografitë e vendit të ngjarjes.

Me daljen në vendshiqim së bashku me ekspertin e gjeodezisë si dhe palët në procedurë me dt.31.10.2023, përveç nxjerrjes së provës me ekspertizë, gjykata ka bërë edhe vendshiqimin, me ç'rast me ndihmën e ekspertit gjeodet ka konstatuar se objekti i kontestit është parcela kadastrale nr. ...-0 ZK K., e cila për momentin është arë e mbjellur me grurë të cilën paditësi deklaroi se e ka mbjellur dje. Kjo parcelë në pjesën perëndimore kufizohet me hekurudhë, në anën veriore kufizohet me parcelën ...-0, në anën lindore kufizohet me parcelën ...-0 ndërsa në anën jugore kufizohet me parcelën ...-0. Në këtë objekt të kontestit nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt. Konstatimet e bëra në teren, janë po ato të cilat i ka prezantuar eksperti me ekspertizën e tij gjeodezike e të cilat kanë përputhje të plotë. Palët në procedurë, nuk kishin bërë vërejtje në konstatimin e gjendjes faktike në teren, të cilën e kishte konstatuar gjykata me ndihmën e ekspertit gjeodet Dr.sc. M.L.

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse, mbante në posedim paluajtshmërinë-njësinë kadastrale ...-0 ZK K., fakt ky i vërtetuar nga dalja e gjykatës në vendshiqim si dhe nga pohimet e palës së paditur.

Fakt kontestes për gjykatën ishte çështja e legjitimitetit real pasiv të paditurit Z. S.K..

Edhe pse i padituri përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar av. M.P. nga Shtërpca e kishte pohuar kërkesëpadinë e paditësit në seancën gjyqësore, në përgjigje në padi etj. gjykata e kishte refuzuar pohimin e kërkesëpadiës me arsyetimin se pohimi i kërkesëpadiës së paditësit nga ana e të paditurit bie ndesh me nenin 3.3 të LPK ku thuhet se: “3.3 Gjykata nuk do t’i miratojë disponimet e palëve që janë në kundërshtim me: a) rendin juridik; b) dispozitat ligjore; c) rregullat e moralit publik.” ashtu që nuk ishin plotësuar kushtet që gjykata të bie aktgjykim në bazë të pohimit.

Përkundër se pala paditëse nuk kishte propozuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë, gjykata e kishte nxjerrë këtë provë sipas detyrës zyrtare, edhe atë konform nenit 21 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LPK, me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe ka dalur në vend shiqim së bashku me palët dhe ekspertin gjeometër.

Ngase prona objekt kontesti gjegjësisht parcela kadastrale ...-0 ZK K. evidentohet në emër të personit S.J.K. kurse jo në emër të paditurit Z.K., gjykata e kishte refuzuar pohimin e

kërkesëpadi së paditësit nga ana e të paditurit sepse sipas vlerësimit të gjykatës assesi nuk mund të pohohet kërkesëpadi e paditësit dhe të vërtetohet pronësia nga ana e palës së paditur kur vetë pala e paditur nuk e gëzon të drejtën e pronësisë. Kjo rregull është rregull e vendosur qysh nga e drejta romake përmes frazës latine “Nemo plus iuris transfere (ad alium) potest quam ipse habet” që nënkupton se askush nuk mund të bartë më shumë të drejta te tjetri sesa që i ka vetë. Shtrohet pyetja si mund të pohohet pronësia nga ana e të paditurit kur vetë i padituri nuk është pronar juridik i pronës objekt kontesti. Për këtë arsye, gjykata me aktvendim procedural e kishte ftuar paditësin që të rregullon padinë në aspektin e legjitimitetit pasiv të palës së paditur duke i dhënë afat të mjaftueshëm kohor brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, sipas aktvendimit të marrë në seancën gjyqësore të datës 11.12.2023, mirëpo përkundër udhëzimit të gjykatës paditësi e kishte njoftuar gjykatën me parashtresën e dt. 29.12.2023 se si palë e paditur duhet të vazhdon të jetë personi Z.K. sepse i njëjti gëzon legjitimitet të plotë real pasiv. Më tej, duke qenë se pala paditëse gjatë gjithë procedurës ishte përfaqësuar vetë dhe jo nga ndonjë profesionisht i fushës juridike, gjykata në seancën gjyqësore të datës 11.12.2023 e kishte njoftuar palën paditëse se mund të angazhonte ndonjë avokat ose përfaqësues të autorizuar duke qenë se kemi të bëjmë me çështje komplekse juridike, por përkundër udhëzimit të gjykatës paditësi kishte vazhduar të përfaqësohej vetë në këtë procedurë pa ndihmën ose angazhimin e ndonjë përfaqësuesi të autorizuar. Për këtë gjykatë është plotësisht e qartë se prona objekt kontesti ..-0 ZK K. evidentohet në emër të personit S.J.K., ndërsa nuk evidentohet në emër të paditurit Z.K. dhe kjo vërtetohet nga certifikata e pronës e siguruar nga ana e ekspertit gjeometër. Andaj kjo ishte arsyeja themelore pse u refuzua si e pabazuar kërkesëpadi e paditësit e drejtuar ndaj të paditurit Z.K.. Se në emër të kujt evidentohet prona objekt kontesti ..-0 ZK K., gjykata këtë e ka bërë përmes nxjerrjes së provës sipas detyrës zyrtare, edhe atë sipas ekspertizës nga lëmi i gjeodezisë Dr.sc. M.L., i cili në ekspertizën e tij e ka përcaktuar se prona ...-0 ZK K. evidentohet në emër të S.K., ndërsa si provë e ka bashkangjitur Raportin nga AKK të datës 31.10.2023. Nëse eventualisht gjykata do të pranonte pohimin e kërkesëpadi së bërë nga ana e të paditurit Z.K., me këtë veprim do të mund të cënonte të drejtat eventuale pronësore të personave tjerë (trashëgimtarë eventuale) të personit të quajtur S.K. dhe mu për këtë arsye gjykata nuk mundet të lejojë pohimin e kërkesëpadi së, ngase në këtë drejtim mund të cenohen interesat e personave të tretë e që nuk janë të përfshirë si palë në këtë çështje kontestimore.

Kruciale është se në provat që i ka shtjelluar gjykata në këtë procedurë civile mungon ndonjë dëshmi e faktit të vdekjes së personit S.K., i cili sipas deklarimeve të palëve në procedurë thuhet të jetë babai i të paditurit dhe në emër të të cilit evidentohet prona në regjistrat kadastral të Komunës së Ferizajt. Kjo gjykatë shton se fakti se paditësi ka në posedim këtë pronë, nuk do të thotë që kjo të njëjtin në mënyrë automatike e bën pronar sepse duhet të dallohet e drejta e pronësisë nga posedimi si gjendje e fundit faktike. Sipas nenit 3.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike i ish RSFJ, ligj i cili ka vlejtur në kohën e krijimit të këtij raporti juridik civil, parashihet se: “Pronari ka të drejtë që sendin e vet ta mbajë, ta shfrytëzojë dhe ta disponojë në kufijtë e caktuara me ligj.” Ndërsa sipas nenit 70.1 të këtij ligji, ku rregullohet posedimi, parashihet se: “Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë).”

Në shkresat e lëndës mungon dëshmia se i padituri është trashëgimtar apo trashëgimtar i vetëm i personit të quajtur S.K.. Çështje tjetër me rëndësi për pasardhësit, si palë të legjitimuar për

shkak të raportit juridiko-civil të paraardhësve është se ata në cilësinë e paditësve janë bashkëndërgjyqës unik, ndërsa në cilësinë e të paditurve janë bashkëndërgjyqës të domosdoshëm (shih faqe 56 të Përmbledhjes nga praktika e Gjykatës Supreme në Kontestet Pronësore, Prishtinë, 2019). Kurse sipas nenit 140.1 të LTK parashihet se: “140.1.Gjer në kohën e ndarjes trashëgimtarët e administrojnë dhe e disponojnë bashkarisht pasurinë trashëgimore.” Kurse në bazë të nenit 124 të LTK parashihet se: “124.1.Me vdekjen e personit hapet trashëgimi i tij. 124.2.Të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit si të vdekur.”, por në shkresat e lëndës mungon dëshmia se kush është trashëgimtar i personit S.K. gjegjësisht a është rregulluar trashëgimia e tij, nëse po a është i padituri trashëgimtar i tij apo a është i padituri trashëgimtar i vetëm i tij. Në shkresat e lëndës nuk gjindet as dëshmia (certifikata) e vdekjes së të paditurit e poashtu dëshmi vdekja ku ceken trashëgimtarët eventuale ose aktvendimi për rregullimin e trashëgimisë së personit S.K..

Sa i përket legjitimitetit pasiv të palës së paditur Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare për arsye se është e karakterit material-juridik. Pala ndaj të cilit drejtohet kërkesa duhet të legjitimohet në aspektin pasiv, për arsye se vetëm përmes saj mund të realizohet kërkesa e paditësit, nëse përmbushen kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë. Gjykata në rastin konkret konstaton se vërtetë të paditurit i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në kontestin lëndor. Kjo për arsye se legjitimiteti real është marrëdhënie e palëve të sajuara në bazë të ndonjë raportit juridik-civil, nga e cila rrjedhin të drejtat subjektive dhe me rastin e cënimit të tyre titullari i të drejtës subjektive të cënuar ka të drejtë të kërkon mbrojtje gjyqësore. Andaj, për këtë arsye dhe duke pasur parasysh faktin se mungesa e legjitimitetit të plotë është e karakterit material-juridik, rezulton se padia dhe kërkesëpadija e paditësit në raport me të paditurin është e pa bazuar. Gjykata vlerëson se i padituri nuk ka bazë juridike për t’ia pohuar kërkesëpadinë paditësit, për arsye se këtë të drejtë edhe vetë i padituri nuk e ka, pra nuk mund të bartë më shumë të drejta te personi i tretë se sa ato që i ka të regjistruara në regjistrat kadastral (kur bëhet fjalë për sendet e paluajtshme). Nuk është plotësuar asnjë kusht i paraparë në nenin 148 të LPK-së që më pastaj të mund të nxirret aktgjykim në bazë të pohimit. Nuk mund të ketë aktgjykim në bazë të pohimit në rastet kur palët nuk mund të disponojnë lirisht me objektin e kontestit dhe se kur disponimet e palëve ndërgjyqëse janë në kundërshtim me dispozitat e detyrueshme, në rastin konkret Gjykata ka vlerësuar se i padituri nuk disponon (nuk është pronar) me të drejtat objekt kontesti dhe pohimi i tij nuk është në përputhje me dispozitën e nenit 148 të LPK-së. Si përfundim kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit të të paditurit, pra përmes tij paditësi nuk mund ta realizon të drejtën e pronësisë, për arsye se as i padituri këtë të drejtë nuk e ka të regjistruar në regjistrat kadastral.

Deklarimit të dëshmitarëve, gjykata nuk ja ka falur besimin fare pasi që për gjykatën deklaratat e tyre nuk janë relevante për kontestin, meqenëse personi nga i cili pretendon paditësi të fitojë (nxjerrë) të drejtën e pronësisë nuk është as vetë pronar i pronës kontestuese, por pronar në regjistrat kadastral figuron të jetë personi i quajtur S.K.

Në kuptim të të thënave më lartë, Gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike - kontestimore duhet të zbatohen dispozitat e ligjit material të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore Nr. 827, dt. 30.01.1980, për shkak se raporti i krijuar është i vitit 1994, andaj

edhe aplikohen dispozitat materiale që kanë qenë në fuqi. Duke u bazuar në nenin 2.2 të LPK-së, “Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”. Në këtë drejtim, ashtu siç është elaboruar më lartë, nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për vërtetim pronësie, qoftë me punë juridike apo me parashkrim fitues e as nga ndonjë bazë tjetër ligjore. Sikur gjykata të veprojë në këtë mënyrë dhe të lejojë palën e paditur të disponojë me të drejtën e saj edhe përkundër faktit se ajo nuk regjistrohet vetë si pronare në regjistrat pronësor kadastral, atëherë gjykata do të bëjë shkelje dhe do të mundet që eventualisht të cenojë të drejtat e personave të tretë, të cilët mund të jenë palë në këtë kontest. Në këtë mënyrë, gjykata konstaton se duke u bazuar në nenin 322.1 dhe 322.2 e lidhur me nenin 319 të LPK-së, barra e të provuarit për faktet e pretenduara i bie palës paditëse. Sa i përket aplikimit të drejtës materiale, apo bazës juridike të kërkesëpadsisë, sipas nenit 2.2 të LPK-së, gjykata nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale, por të njëjtën e çmon sipas çmuarjes së lirë. Gjendja e fakteve është poashtu kontradiktore në këtë çështje, deri sa në njërën anë paditësi në parashtrësën e tij të dt. 19.12.2023 pretendon se “shitësi i parcelës kadastrale është S.K. ndërsa blerës është K.J.” (fq.2, rreshti 1 dhe 2 i parashtrësës), me deklaratën e dëshmitarit R.J., i cili ka deklaruar në shqyrtimin gjyqësor të dt. 11.12.2023, në pyetjen e paditësit se: “a e kam blerë tokën nga Z.i”, i njëjti përgjigjet: “po, para luftës ka qenë diku në vitin 1993-4 ku e ka blerë nga Z.i në mos gabofsha ka qenë në shumën prej 400 mark për ari”, poashtu dëshmitari A.J. ka deklaruar në pyetjen e paditësit se “a e kam blerë tokën nga Z.i si dhe a e kam paguar”, i njëjti përgjigjet: “në vitin 1993 e ka blerë tokën J. babai i K. nga Z.i”.

Gjykata me këtë rast vë theksin se në procedurë kontestimore vendos brenda kufijve të kërkesave të palëve, bazuar në nenin 2.1 të LPK-së në të cilin parashihet se: “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata e ka refuzuar kërkesëpadsinë e paditësit, gjë të cilën e vlerësoi si konstatim të drejtë, të ligjshëm dhe që i shërben qëllimit të kontestit, pasi që sipas provave të lartcekura nuk u vërtetua se personi i cili paraqitet si palë e paditur në këtë kontest gjegjësisht i padituri Z.K. e gëzon të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kadastrale ...-0 ZK K., me të dhënat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata nuk u lëshua në shqyrtimin e çështjeve tjera pasi që të njëjtat nuk ishin fare relevante për vendosjen e lëndës, kurse çështja e legjitimitetit real pasiv ishte çështja kryesore dhe vendimtare e këtij procesi gjyqësor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 sepse asnjë nga palët nuk i ka kërkuar.

Nga të gjitha të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143.1 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj
C.nr.1312/20, datë 03.04.2024

Gjyqtari
Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.